

Instituti GAP

Letërnjoftimi i Komunës së Mamushës - 2013

Maj, 2013

“Letërnjoftimi i Komunave” është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale tri vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. Hyrje.....	4
2. Performanca buxhetore e Komunës së Mamushës	5
3. Investimet kapitale.....	7
4. Të dhënat e përgjithshme për Administratën e Komunës së Mamushës	8
5. Transparenca në Komunën e Mamushës.....	9
6. Burimet	11

Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Mamushës gjendet në jugperëndim të Kosovës dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 32 km². Kjo komunë është krijuar nga zonat kadastrale të Prizrenit, fillimisht si pilot njësi komunale (2005-2007) për t'u shndërruar në komunë me kompetenca të plota në qeverisje lokale që nga janari i vitit 2010. Pjesa dërrmuese e popullsisë i takon komunitetit turk të Kosovës. Përpos të hollave që ndan rregullisht Qeveria e Kosovës, edhe donacionet nga shteti i Turqisë kanë ndikuar në arritjen e disa objektivave nga udhëheqja e Komunës së Mamushës. Disa rrugë dhe institucione në këtë komunë bartin emërtime nga personalitetet historike të Turqisë.

Megjithëse Mamusha po e përmbyll vitin e katërt të ekzistimit si komunë me kompetenca të plota, ndërtimi i administratës komunale dhe i bazës juridike ende nuk është finalizuar. Komuna akoma nuk ka nisur me procesin e dhënies së lejeve të ndërtimit, me finalizimin e planeve rregulluese si dhe nuk është hasur ndonjë rast i partneritetit publiko-privat në zhvillimin e sektorëve të ndryshëm.

Niveli i përgjithshëm i të hyrave komunale të Mamushës gjatë një viti sillet rreth 42.000 euro, shumë kjo tejet simbolike për të mundësuar investime të mëdha nga ana e komunës. Mbi 95% e buxhetit të Mamushës është nga grantet e Qeverisë së Kosovës. Shuma e mjeteve që Mamusha ka gjatë një viti për investime kapitale sillet rreth 240.000 euro.

Zyrtarët e lartë të Komunës së Mamushës (kryetari, nënkryetari, drejtorët e drejtorive) kanë refuzuar të deklarojnë pasurinë në Agjencinë Kosovare kundër Korrupsionit në vitin 2012. Ndërkaq, Auditori i Përgjithshëm thotë se raportimi i shpenzimeve nuk është saktësuar siç duhet.

Nga 15 asambleistë sa numëron Kuvendi Komunal, vetëm dy prej tyre janë femra. Edhe përqindja e punësimit të femrave në administratën komunale, në arsim dhe shëndetësi është i vogël. Nga gjithsej 126 persona të punësuar në këta sektorë, vetëm 28 janë femra.

Komuna e Mamushës akoma nuk ka themeluar Zyre për Marrëdhënie me Publikun dhe nuk ka emëruar ndonjë zyrtar përgjegjës për komunikim me media. Përveç kësaj, ueb faqja zyrtare e kësaj komune është tejet e varfër me informacione. Ajo nuk përmban asnjë raport financiar, raport të punës, njoftimet e prokurimit publik dhe dokumente të tjera të rëndësishme.

Regjioni i Mamushës është i njohur për organizimin e festivalit tradicional të domates. Gjatë vitit të kaluar, komuna ka shpenzuar afro 6.000 euro për bileta të aeroplanit për mysafirët e këtij festivali të ardhur nga jashtë në Kosovë. Ndërsa, për ushqim dhe pije për këtë festival për çdo vit nga buxheti i komunës shpenzohen mbi 9.000 euro.

1. Hyrje

Mamusha është formuar si komunë nga procesi i decentralizimit, i nisur në fillim të vitit 2007. Në atë kohë, Mamusha, Juniku, Graçanica, Klllokoti, Parteshi dhe Hani i Elezit kanë fituar epitetin e pilot njësisë komunale për t'u shndërruar në komuna të plotfuqishme nga janari i 2010, përkatësisht pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale në vend.¹

Në Komunën e Mamushës jetojnë 5.507 banorë, prej tyre 5.128 apo mbi 92%² janë me përkatësi etnike turke. Kjo komunë shtrihet në juglindje të Kosovës dhe mbulon një sipërfaqe prej rreth 32 km². Më herët Mamusha ka qenë pjesë territoriale dhe administrative e Prizrenit.

Kryetar i kësaj komune në zgjedhjet e nëntorit të vitit 2009 është zgjedhur Arif Bütüç nga Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP). Komuna e Mamushës ka gjithsej gjashtë drejtorë dhe dy nënkryetarë. Një nga pozitat e nënkryetarit ushtrohet nga një përfaqësuese shqiptare, Ganimete Sadiku.

Kryetari Arif Bütüç ka fituar qysh në rrethin e parë të zgjedhjeve, me 80.1% të votave ndaj kundër kandidatëve të tij nga AKR dhe PDK. Kandidati i AKR, Mehmet Mazreku, ka marrë 12.6% të votave, ndërsa kandidati nga PDK Berzat Morina 7.8%.

Kuvendi i Komunës së Mamushës përbëhet prej 15 asambleistëve, 11 prej tyre janë nga KDTP, dy përfaqësues janë nga AKR, një përfaqësues nga PDK dhe një përfaqësues ka fituar vota për të hyrë në Kuvend të Mamushës si kandidat i pavarur.³

Në këtë raport pasqyrohen zhvillimet rreth politikave publike në Komunën e Mamushës për periudhën janar 2010 - dhjetor 2012, ku Instituti GAP ka analizuar ecurinë buxhetore të kësaj komune, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet komunale, ka analizuar trendin e investimeve kapitale dhe si është dhënë vlerësim i përgjithshëm në lidhje me funksionimin e administratës komunale si dhe nivelin e shkallës së transparencës të organeve komunale ndaj qytetarëve dhe opinionit të gjerë.

¹Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Raport vlerësimi. Nga pilot njësi komunale në komuna me të drejta te plota. Fq 4-5. Burim: <http://www.osce.org/sq/kosovo/67466>

²Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

³Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rezultatet përfundimtare për Kuvendet komunale nga zgjedhjet lokale të vitit 2009. Fq 34. Komuna e Mamushës. Burimi: <http://www.kqz-ks.org/sq/rezultatet-2009/Index>

2. Performanca buxhetore e Komunës së Mamushës

Përgjatë viteve 2010-2012, Komuna e Mamushës, ka shpenzuar buxhet në vlerë prej 3 milionë euro. Llogaritur edhe me shumën e mjeteve që kjo komunë ka në dispozicion për vitin 2013, rezulton se Mamusha gjatë këtij mandati katër vjeçar, 2010-2013, do të shpenzojë mbi 4.1 milionë euro. Shuma më e madhe e këtyre mjeteve janë dedikuar për paga, pastaj për investime kapitale, mallra dhe shërbime dhe në linjat tjera të buxhetit si për subvencione dhe shpenzime komunale.

Tabela nr.1: Orientimi i mjeteve financiare nga Komuna e Mamushës gjatë katër viteve (2010-2013) llogaritur në total

Fushat	Shuma
Për investimet kapitale	1.011.300
Për paga	2.564.323
Për subvencione	9.047
Për shpenzime komunale	87.784
Për mallra dhe shërbime	444.316
Gjithsej	4.116.770

Tabela nr.2: Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Mamushës sipas viteve (2010-2013)

Kategoria	Plani 2013	2012	2011	2010
Investime Kapitale	235.017	258.310	304.335	213.638
Mallra dhe shërbime	96.136	160.392	75.123	112.665
Subvencion dhe transfere	3.000	3.000	1.547	1.500
Shpenzime komunale	22.300	23.240	21.122	21.122
Paga	707.833	699.881	631.432	525.177
Gjithsej	1.064.336	1.144.823	1.033.559	874.102

Mbi 98% e buxhetit për Komunën e Mamushës sigurohet nga granti qeveritar, përkatësisht nga mjetet që ndan niveli qendror si grant operativ për komuna. Brenda grantit nga niveli qendror hyn edhe granti specifik për arsim, ai për shëndetësi si dhe qarkorja e programuar për paga. Niveli i të hyrave komunale nga Mamusha është tejet simbolik, përkatësisht gjatë një viti kjo komunë mbledh rreth 42.000 euro të hyra. Ndonëse ka tri vite që Mamusha është shndërruar në komunë, akoma nuk ka nisur inkasimi i të hyrave nga lejet e ndërtimit, shfrytëzimi i hapësirave publike, inspekcioni si dhe disa fusha të tjera.

Tabela nr.3: Pasqyrimi i të hyrave komunale në dy vitet e fundit sipas sektorëve në Komunën e Mamushës

Linja e të hyrave	Shuma (euro)	
	2011	2012
Të hyra nga administrata	5.441	6.380
Të hyra nga gjeodezia dhe katastri	1.898	1.785
Të hyra nga sektori i shëndetësisë	4.793	4.982
Të hyra nga gjobat policore ne trafik dhe gjykata	8.275	5.465
Të hyra nga tatimi në pronë	11.830	13.444
Të hyra nga taksa rrugore	5.280	5.140
Të hyra nga taksa në biznes	3.815	5.454
Të hyra nga lëshimi i lejeve të punës	1.000	00
Gjithsej	42.332	42.650

Tabela nr.4: Krahasimi i shpenzimeve në disa kategori në linjën për mallra dhe shërbime mes vitit 2012 dhe 2011

Kategoria	2012	2011
Shpenzimet në telefonin mobile	6.523	3.114
Shpenzimet në telefoni fikse	4.872	6.291
Shpenzimet për darka dhe dreka zyrtare	1.268	3.715
Shpenzimet derivate për vetura	9.125	5.901
Shpenzime për udhëtime dhe mëditje jashtë vendit	4.071	2.830

Shuma e parave që ka pasur në dispozicion Komuna e Mamushës gjatë vitit 2012 për mallra dhe shërbime ka qenë mbi 160.000 euro, apo shumëfish më shumë se niveli i të hyrave komunale. Raportet Financiare të Komunës së Mamushës për vitin 2011 dhe 2012 përcillen me gabime në specifikimin e vitit dhe në specifikimin e shifrave të mjeteve të përdorura në kategoritë e caktuara. Kjo e bën të pamundur saktësimin e të dhënave në lidhje me shpenzimet. Këto gabime janë konstatuar dhe evidentuar edhe nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të vendit.⁴

Asnjëri nga zyrtarët e lartë të Komunës së Mamushës nuk e kanë deklaruar pasurinë në Agjencinë Kosovare kundër Korrupsionit për vitin 2012⁵, gjë e cila obligohet me Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollimin e Pasurisë.⁶

⁴Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Mamushës për vitin 2011. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/Mamusha_31_12_2011_Final_alb_784860.pdf

⁵Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit. Deklarimi i pasurisë. Komuna e Mamushës. 2012. Burimi: http://akk-ks.org/index.php?cid=1,1190&path=Komunat/Komuna_e_Mamushës

⁶Kuvendi i Kosovës. Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollimin e Pasurisë. Ligji nr.03/L-151. Burimi: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-151-alb.pdf>

Komuna e Mamushës është e njohur për organizimin e festivalit të domates. Gjatë vitit 2012, me rastin shënimit të kësaj dite, kjo komunë ka paguar biletat e aeroplanit për disa të ftuar të ardhur nga jashtë Kosovës. Biletat dhe bartja me autobus e mysafirëve i ka kushtuar buxhetit të Mamushës 5.569 euro.⁷ Ndërkaq sigurimi i ushqimit dhe organizimi i këtij festivali i ka kushtuar buxhetit të Mamushës 9.422 euro.

3. Investimet kapitale

Mundësitë buxhetore të Komunës së Mamushës mbeten tejet të vogla për të realizuar investime të gjëra kapitale. Gjatë një viti, kjo komunë ka në dispozicion rreth 240.000 euro për të investuar. Pjesa më e madhe e investimeve të hasura në Komunën e Mamushës gjatë tri viteve të fundit ka ardhur nga donacionet ndërkombëtare, përkatësisht nga kontingjenti i KFOR-it turk në Kosovë si dhe nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian. Kjo e fundit ka ndërtuar objektin e ri të administratës komunale, ka investuar në gjelbërimin e zonave si dhe ka përkrahur financiarisht riparimin e shkollës së vetme fillore të kësaj ane.

Tabela nr. 5: Pasqyrimi i disa nga investimet kapitale të Komunës së Mamushës gjatë vitit 2010, 2011 dhe 2012

Projektet kryesore të realizuara gjatë 2010-2012	Shuma (euro)
Furnizim me shporta te mbeturinave	14.955
Furnizim me inventar për shkollën fillore	5.674
Hartimi i projektit për rregullimin e rrugës Reti	2.981
Asfaltimi i rrugës në relacionin Mamushë - Reti	198.840
Rregullimi i bazës së poshtme të tregu	7.800
Rregullimi i parqeve publike	8.886
Furnizimi me dru për QMF dhe shkollën fillore	9.900
Dekorimi i urës në pjesën hyrëse të Mamushës	13.306
Shtruarja e rrugëve lokale me kubeza	54.103
Furnizimi me inventar për komunën	5.600
Pastrimi i rrugëve dhe heqja e mbeturinave	9.901
Pastrimi i lumit Toplluha	9.331
Ndërtimi i urës mbi lumin Toplluha –Faza e Dytë -	34.566
Ndërtimi i urës mbi lumin Toplluha –Faza e Parë -	89.137
Sinjalizimi vertikal i rrugëve në Mamushë	6.000
Furnizimi me gypa ujës-jellësi	19.435
Ndërtimi i murit mbrojtjes përgjatë lumit Toplluha	135.996
Largimi i shtyllave të tensionit të lartë nga qyteza	26.750
Rrethojat në zonën e varrezave	14.900

⁷Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. 2012. Komuna e Mamushës. Njoftimet e shpallura. Burimi: <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=60147>

Shtuarja me zhavorr e rrugëve bujqësore	22.592
Hapja e pusit të ujit për nevojat e zjarrfikëseve	3.995
Rregullimi hapësirës për tregun e gjelbër	4.700
Vendosja e pompës së ujit me kapacitet të mesëm	7.859
Ndërtimi i parkut në zonën e quajtur Neperbishtë	7.946
Investime për pyllëzimin e zonave	4.986

4. Të dhënat e përgjithshme për Administratën e Komunës së Mamushës

Komuna e Mamushës numëron gjithsej 126 persona të punësuar, duke përfshirë të punësuarit në shkollën fillore “Haxhi Ymer Lutfiu”, në shkollën e mesme “Ataturku” si dhe në Qendrën e Mjekësisë Familjare (QMF). Administrata e komunës ka gjithsej gjashtë drejtori dhe katër zyre. Drejtoritë janë: Drejtoria e Administratës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Inspektionit, dhe Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi. Ndërsa zyrat janë brenda funksioneve bartëse të zyrës së Kryetarit, përkatësisht Zyra e Prokurimit, Zyra e Personelit, Zyra për Komunitete.⁸

Tabela nr.6: Pasqyrimi i numrit të të punësuarave sipas drejtorive dhe sektorëve në Komunën e Mamushës dhe vështrimi gjinor

Drejtoritë/Sektorët	Numri i të punësuarave	F	M
Zyra e Kryetarit	13	4	9
Drejtoria e Administratës	10	2	8
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	6	2	4
Drejtoria e Arsimit	4	0	4
Drejtoria e Inspektionit	4	0	2
Drejtoria e Shëndetësisë	1	0	1
Drejtoria e Katastrit dhe Gjeodezisë	5	1	4
Zyra e Prokurimit	2	0	2
Zyra për Komunitete	2	0	2
Zyra e Personelit	1	0	1
Shkolla fillore/stafi	34	11	23
Shkolla e mesme/stafi	7	3	4
Qendra e Mjekësisë Familjare	17	3	14
Qendra për punë Sociale	2	0	2
Zyra e Kuvendit komunal	18	2	16
Gjithsej	126	28	98

⁸Komuna e Mamushës. Statuti i Komunës së Mamushës. Burimi: <http://kk.rks.gov.net/mamushë/getattachment/Municipality/Statut/statuti-i-Komunes-se-Mamushës.pdf.aspx>

Përfaqësimi i femrës në pozitë e punës në komunë mbetet tejet i vogël. Nga gjithsej 15 asambleistë sa numëron Kuvendi, vetëm dy prej tyre janë femra, apo 13% e përfaqësimit në total. Kjo bie ndesh me Ligjin për Zgjedhjet Lokale.⁹

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në një raport ka konfirmuar se kapacitetet e komunës së Mamushës lëvizin nga niveli bazik në nivelin e mesëm. “Vlerësimet tregojnë se niveli bazik dhe i mesëm nuk janë në përputhje me synimet për një administratë komunale moderne dhe profesionale”, thuhet në raportin vlerësues të kapaciteteve në fushën e kompetencave vetanake dhe të deleguara.¹⁰ Kapacitete të nivelit të ultë janë vlerësuar në fushat e mbrojtjes së mjedisit, menaxhimin e pronës publike dhe infrastruktura e turizmit kulturor. Ndërsa kapacitete të nivelit bazik janë vlerësuar në fushën e arkivit institucional, arsimin parauniversitar, personeli arsimor, menaxhimi i burimeve njerëzore, shërbimet sociale, menaxhimi i tokës, planet zhvillimore urbane dhe rregullave, menaxhimi i tokës bujqësore, standardet për kontrollin e ndërtimeve dhe Inspekcioni.¹¹

5. Transparenca në Komunën e Mamushës

Komuna e Mamushës është e vetmja komunë në nivel të vendit e cila nuk ka të themeluar zyre për informim apo për marrëdhënie me publikun. Asnjë zyrtar nuk është përgjegjës për dhënien e informatave nga kjo komunë. Kjo ka ndikuar që Komuna e Mamushës të ketë nivel të ulët të transparencës. Kësaj i kontribuon edhe mungesa e pranisë së përhershme të medieve por edhe OJQ-ve lokale. Pavarësisht kësaj, komuna mund t’u ofrojë qytetarëve qasje në informata përmes ueb faqes zyrtare të komunës, mekanizëm ky që pothuajse nuk është shfrytëzuar fare nga qeveria komunale. Ueb faqja e komunës nuk freskohet me të dhëna, ndërkohë që mungojnë edhe të dhënat themelore mbi funksionimin e komunës dhe vendimmarrjen. Duke pasur parasysh faktin se kryetari i komunës së Mamushës dikur ka ushtruar profesionin e gazetarit, ai do të duhej të insistonte që ueb faqja e komunës të azhurnohet me informatat e nevojshme.

Gjatë vitit 2012 dhe 2013, Instituti GAP ka dërguar kërkesë për qasje në të dhënat e detajuara të shpenzimit të buxhetit të komunës ku kemi marrë përgjigje jo të plotë nga ana e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në këtë komunë.

⁹Kuvendi i Kosovës. Ligji për Zgjedhjet Lokale. Fq 5. Neni 7. Burimi: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L072_al.pdf

¹¹Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal. Raport: Vlerësimi i kapaciteteve të komunave në fushën e kompetencave vetanake dhe atyre të deleguara. Burimi: <http://www.mapl-ks.org/repository/docs/Mamushe.pdf>

Tabela nr. 7: Vlerësim i përmbajtjes së ueb faqes së Komunës së Mamushës.

<http://kk.rks-gov.net/mamushe/Municipality/Departments.aspx>

Dokumenti	2010				2011				2012			
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Drejtoria e Shëndetësisë	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Drejtoria e Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Drejtoria e Inspektionit	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Drejtoria për Gjeodezi dhe Kataster	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurimit	x											
Raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm	x											
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	x				x				x			
Rregulloret Komunale	√											
Vendimet e Kuvendit Komunal	x				√				√			
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal	x											
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Planet dhe Strategjitë e Komunës	x											

X = mungon raporti. √= raporti është i publikuar në ueb-faqe.

6. Burimet

1. Komuna e Mamushës. Raporti financiar janar – dhjetor 2011.
2. Komuna e Mamushës. Raporti financiar janar – dhjetor 2012.
3. Komuna e Mamushës. Drejtoria e Administrates. Lista e të punesiareve në sektorë publik të Mamushës. Mars 2013.
4. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Raport vlerësimi. Nga pilot njësi komunale ne komuna me te drejta te plota.. Burim: <http://www.osce.org/sq/kosovo/67466>
5. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf
6. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rezultatet përfundimtare për Kuvendet komunale nga zgjedhjet lokale të vitit 2009. Komuna e Mamushës. Burimi: <http://www.kqz-ks.org/sq/rezultatet-2009/Index>
7. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Mamushës për vitin 2011. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/Mamusha_31_12_2011_Final_alb_784860.pdf
8. Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit. Deklarimi i pasurisë. Komuna e Mamushës. 2012. Burimi: http://akk-ks.org/index.php?cid=1,1190&path=Komunat/Komuna_e_Mamushës
9. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollimin e Pasurisë. Ligji nr.03/L-151. Burimi: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-151-alb.pdf>
10. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. 2012. Komuna e Mamushës. Njoftimet e shpallura. Burimi: <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=60147>
11. Komuna e Mamushës. Statuti i Komunës së Mamushës. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/mamushe/getattachment/Municipality/Statut/statuti-i-Komunes-se-Mamushës.pdf.aspx>
12. Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal. Raport: Vlerësimi i kapaciteteve të komunave në fushën e kompetencave vetanake dhe atyre të deleguara. Burimi: <http://www.mapl-ks.org/repository/docs/Mamushe.pdf>
13. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Zgjedhjet lokale. Neni 7. Burimi: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L072_al.pdf
14. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011. Burimi: <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/11052012.pdf>